

## Termet e Referencës Ekspert/e i/e jashtëm/me

### 1. Përmbledhje

Titulli i projektit: Ruralbania: Nisma për mbështetjen dhe promovimin e produkteve bujqësore tradicionale për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale shqiptare

Kontrata e Grantit: AID 012590/03/6

Periudha: Prill 2024 – Maj 2024

Roli: Ekspert/e i/e jashtëm/me për Jurinë e vlerësimit të programit të bursave për të rinjtë e talentuar në bujqësi dhe zhvillim rural

Vendi: Tiranë

Përgjegjësi: Koordinatorja Kombëtare, ANRD

### 2. Background

#### Objektivi kryesor

Në kuadër të projektit Ruralbania, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural hap thirrjen për programin e bursave me qëllimin për të ndihmuar fuqizimin e sipërmarrësve të rinj të angazhuar në sektorin e bujqësisë, në zinxhirët e furnizimit në qarqet e Shkodrës, Kukësit dhe Dibrës. Programi synon të identifikojë dhe të ofrojë mbështetje për fermerët e rinj të talentuar në këto zona, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre, si dhe të sigurojnë burime për të rritur dhe zhvilluar bizneset e tyre në fushën e bujqësisë. Për të arritur këtë, programi do të nxisë rritjen e njohurive të tyre përmes kurseve të trajnimit të kualifikuar dhe do të sigurojë mbështetje financiare për blerjen e inputeve të prodhimit, inovacioneve teknologjike dhe diversifikimin e fermave. Përbushja e këtij qëllimi synon të krijojë një efekt zinxhir që do të mbështesë avancimin e fermerëve të rinj drejt suksesit në sipërmarrje duke kontribuar kështu në zhvillimin rural dhe përmirësimin e cilësinë së jetesës në komunitetet e tyre.

#### Objektivat specifikë

- Zhvillimi i njohurive dhe aftësive të fermerëve të rinj të përzgjedhur përmes trajnimeve të kualifikuara në lidhje me tema të ndryshme të identifikuara nga vetë të rinjtë;
- Përmirësimi i performancës së proceseve të punës të fermave, përmes mbështetjes financiare për investime në asete prodhuese dhe inpute bujqësore.
- Nxitja e përdorimit të praktikave inovative dhe teknologjive të reja për të kontribuar një sektor bujqësor eficient, modern dhe të gjelbër.

### 3. Detyra e përgjithshme

Eksperti/e i/e jashtëm/me do të jetë pjesë e Jurisë së vlerësimit, duke ofruar njohuritë dhe aftësitë e veta në procesin e vlerësimit të propozimeve të paraqitura nga aplikantët, siç përcaktohet në Udhëzuesin e Programit të Bursave.

### 4. Detyra specifike

Eksperti/e i/e jashtëm pritet të:

-Shqyrtojë paraprakisht aplikimet e marra dhe t'i vlerësojë ato në mënyrë të pavarur;

- Marrë pjesë në takimet e Jurisë së vlerësimit, për të kryer funksionet e vlerësimit sipas Udhëzuesit të Programit të Bursave;

- Marrë pjesë në mënyrë proaktive në mbledhjet Jurisë së vlerësimit, duke kontribuar në vlerësimin e duhur dhe objektiv të propozimeve të paraqitura përpara se anëtarët të shprehin votat e tyre sipas Udhëzuesit të Programit të Bursave;
- T'i japë rekomandime Ekipit të Projektit për të lehtësuar shqyrtimin e propozimeve të parapërzgjedhura përpara nënshkrimit të marrëveshjeve financiare me përfituesit;
- Të kryejë të gjitha detyrat e tij/saj duke respektuar afatet e dakordësuara, me integritet të lartë dhe në përputhje të plotë me parimet e sjelljes së mirë.

### 5. Rezultatet:

- Pjesëmarrja proaktive dhe kontributi cilësor në punimet e Jurisë së vlerësimit, duke siguruar vlerësim të drejtë dhe objektiv të propozimeve të paraqitura;
- Rekomandime për Ekipin e Projektit për të thjeshtuar procesin e shqyrtimit të aplikimeve të parazgjedhura përpara nënshkrimit të Kontratave.

### 6. Kohëzgjatja dhe periudha

Detyra pritet të kërkojë gjithsej 3 ditë angazhimi në Tiranë, përgjatë muajit maj 2024. Numri i saktë i ditëve mund të ndryshojë, në varësi të nevojave që dalin gjatë procedurave të vlerësimit.

### 7. Eksperienat e kërkuara

- Diplomë universitare në sektorët përkatës, veçanërisht me specializim në Bujqësi dhe Zhvillim dhe Rural, Menaxhim Agro-Biznesi apo ndonjë fushë tjetër të ngjashme;
- Të njohë gjuhën angleze
- Eksperiençë profesionale 5-vjeçare e dëshmuar në fushën e Bujqësisë/Agrobiznesit, Fuqizimit Rinor, etj.
- Të mos jetë në një situatë konflikti interesi;
- Banues/e në Shqipëri;
- Jo-banues/e ose i/e lindur në zonat e synuara të Programit të bursave.
- Të mos ketë pasur ndonjë rol të mëparshëm në Projekt (p.sh. si ofrues shërbimi, ekspert i jashtëm, trajner, etj.);
- Njohuri të mira në lidhje me sfidat e zhvillimit rural dhe bujqësor si dhe të rinjve në zonat rurale, veçanërisht në zonat e synuara të Programit të bursave;
- Njohuri të mira rreth institucioneve/organizatave që ofrojnë mundësi për formim profesional dhe trajnime dhe kualifikime të ndryshme;
- Niveli i lartë i profesionalizmit dhe integritetit;
- Aftësitë për të punuar në mënyrë të pavarur në afate të shkurtra, dhe në koordinim më antarët e tjerë vlerësues;
- Motivim i fortë dhe vëmendje ndaj detajeve, veçanërisht në lidhje me të rinjtë, temat e zhvillimit rural dhe procedurat e vlerësimit.

### 8. Raportimi

Eksporti do t'i kërkojë një raport i shkruar, duke përfshirë rekomandimet e veta për Ekipin e Projektit në mënyrë që të thjeshtojë procesin e shqyrtimit të aplikimeve të parapërzgjedhura përpara nënshkrimit të Kontratës me përfituesit e bursave;

Raportimi do të përfshijë: identifikimin e aspekteve problematike në aplikim dhe rekomandime për përmirësimin e aplikimeve, kryesisht të identifikimit të nevojave për trajnim dhe asete prodhuese të propozuara;

Raporti kërkojë t'i dërgohet Koordinatorës Kombëtare të ANRD mundësisht brenda maksimumit 5 ditë pune nga dita e fundit e Procesit të Vlerësimit.

Miratimi i raportit nga Koordinatorja do të jetë bazë për dhënien e rimbursimit përfundimtar të shpenzimeve të kryera nga eksperti/ja për angazhimin.

## **PËR TË APLIKUAR**

Ftohen të interesuarit të dorëzojnë CV të përditësuar (në formatin Europass) dhe një dokument identifikimi nëpërmjet emailit në: [info@anrd.al](mailto:info@anrd.al), deri më 30 prill, ora 17:00.

Aplikime të dorëzuara në mënyrë tjetër nuk do të merren në konsideratë.

Vetëm individët të përzgjedhur do të kontaktohen nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural.